



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale  
Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite  
Ministry of Labour and Social Welfare



AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
AGENCIJA ZA ZAPOŠLJAVANJE REPUBLIKE KOSOVA  
EMPLOYMENT AGENCY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## ZGJATJE E AFATIT TE THIRRJES PËR APLIKIM PROGRAMI I VETËPUNËSIMIT për personat e riatdhesuar

**Me qëllim të ofrimit të mbështetjes për personat e riatdhesuar në Kosovë, në realizimin e planeve të tyre të biznesit, dhe si përpjekje e shtuar për të ndihmuar rimëkëmbjen ekonomike gjatë përballjes me pandeminë COVID-19:**

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) - Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK) në bashkëpunim me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), me mbështetje nga Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar (DRPR) - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), zgjasin afatin e thirrjen për aplikim për **Programin e Vetëpunësimit** për personat e riatdhesuar deri me datë 16 shtator 2020.

### **MBËSHTETJA NGA PROGRAMI**

Programi i Vetëpunësimit do të sigurojë **mjete dhe pajisje teknike bazike**, sipas profileve të pranuar në këtë shpallje për çdo plan të biznesit të zhvilluar me sukses.

#### ➤ **Si të aplikoni?**

- Kompletoni **Formularin e aplikimit për plan të biznesit** të cilin duhet ta dorëzoni përmes postës elektronike: [almp.ks@undp.org](mailto:almp.ks@undp.org). Formularin dhe informacionet tjera mund ti gjeni në adresat elektronike <https://mpms.rks-gov.net/shpallje/njoftime/> dhe <https://aprk.rks-gov.net/sq-AL/Content/Documents?doctype=2/>;
- Aplikantët janë të obliguar të sigurojnë si bashkëlidhje në mënyrë elektronike *Formularin e Aplikimit*;
- *CV-në e tyre nga SIMP (nga Zyra e Punësimit)*;
- *Çertifikatën e trajnimit në Qendrën e Aftësisit profesional (nëse e posedojnë)*;
- *Çertifikatën e trajnimit nga ndonjë organizatë tjetër e akredituar*;
- *Dëshmi mbi kualifikimin dhe përvojën e tyre që përputhet me idenë e paraqitur të biznesit si dhe dokumentet tjera përcjellëse të cilat përshkruhen në Planin e Biznesit (Pjesa e Udhëzimeve)*;
- Secili aplikant mund të aplikojë me vetëm një plan të biznesit (një anëtar për familje);
- Aplikantët të cilët posedojnë biznese të regjistruara në ARBK dhe këto biznese nuk i kanë aktive, duhet të sjellin dëshmi që e kanë filluar procedurën e mbylljes së biznesit jo aktiv që figuron si i regjistruar në sistemin e ARBK-së;

## Afati i aplikimit: deri 16 shtator 2020

### Vërejtje:

- Aplikanti duhet të zgjedhë vetëm njërin nga profilet e lejuara;
- Profile tjera që nuk janë listuar në këtë listë nuk mbështetën nga Programi;
- Ofertat/faturat nuk pranohen si dokumentacion përbërës në kuadër të aplikimit;

### ➤ Profesionet e pranuarra për të cilat ofrohen mjete dhe pajisje sipas sektorëve:

- Përpunimi i ushqimit dhe industria e paketimit:
  - **Përgatitja e ëmbëlsirave**
  - **Përgatitja e ushqimeve të shpejta**
  - **Përpunimi i mishit (përgatitja e produkteve të bluara)**
- TIK krahas me kontraktimin e jashtëm të proceseve të biznesit dhe sektori i qendrave të mbështetjes për konsumatorë:
  - **Zhvillimi i Programeve**
  - **Servisimi i pajisjeve në kuadër të TIK**
  - **Printimi i dizajneve për suvenire**
- Ndërtimtaria:
  - **Instalues i ngrohjes qendrore**
  - **Suvatues dhe Fasadues**
  - **Instalues i sanitarisë/qeramikës**
  - **Instalues elektrik**
  - **Murator**
- Industria e përpunimit të metalit:
  - **Saldues/Metalpunues**
- Industria e tekstilit:
  - **Rrobaqepës**
  - **Qëndisje**
- Industria e përpunimit të drurit:
  - **Zdrukthëtar/Mobileri**
- Tjera:
  - **Floktar/Berber,**
  - **Auto-Mekanik,**
  - **Auto-Ngjyrosje,**
  - **Gomister,**
  - **Auto-Larje**

Për më shumë informata, luteni që të vizitoni adresat elektronike: <https://apr.k.rks-gov.net/> apo <https://mpms.k.rks-gov.net/>, ose Zyrat e Punësimit në komunën tuaj.

Në rast se keni pyetje në lidhje me Programin e Vetëpunësimit, ju lutem kontaktoni projektin ALMP2/UNDP në adresën elektronike: [almp.ks@undp.org](mailto:almp.ks@undp.org).

## **COVID-19**

### **KUJDES I VEÇANTË gjatë procesit të aplikimit:**

- *Bartja e maskave, mbajtja e distancës dhe larja e duarve sipas udhëzimeve të IKSHP-së dhe OBSH-së;*
- *Në çdo zyre do të mbahet distanca në të gjitha hapësirat prej 2 metrave;*
- *Asnjë aplikues nuk lejohet të hyjnë brenda institucioneve pa maskë;*